



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
ZYRA E AUDITORIT PËRGJITHSHËM/ KANCELARIJA GENERALNOG  
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

**Nr. dok. 21.1.1-2009-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
MBI PASQYRAT FINACIARE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT TË  
KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2009**

Prishtinë, Qershor 2010

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

- I. Përmbledhje e Përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Objektivi i Auditimit dhe Fushëveprimi
- IV. Qasja e Auditimit
- V. Opinioni i Auditimit
- VI. Gjendja e Rekomandimeve të Vitit të Kaluar
- VII. Të Gjeturat dhe Rekomandimet Kryesore të Auditimit

### Shtojcat:

- I. Llojet e Ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)
- II. Komentet e Entitetit të Audituar dhe Konkluzionet e ZAP-it

## Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshem
ZKM	Zyra e Kryeministrit
AK	Autoritet Kontraktues
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve të Auditimit Suprem
LMFPP	Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048
LPP	Ligji i Prokurimit Publik nr. 02/L-99
MEF	Ministria për Ekonomi dhe Financa
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OE	Operatorë Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
TI	Teknologjia Informative
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
AUV	Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës

## I. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës (Me tutje, ZKM) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare, në të gjitha aspektet materiale, *prezantojnë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të ZKM-së për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2009 në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) “raportimi financiar, në bazë të kontabilitetit të parasë se gatshme” (SNISA 400 Opinion i Pakualifikuar).*

Përkundër raportimit të duhur financiar, auditimi ynë ka identifikuar një numër të caktuara të mangësive në fushën e menaxhimit financiar dhe kontroleve, por të cilat nuk ndikojnë materialisht në kualitetin dhe besueshmërinë e të dhënave të paraqitura në P/F. Dobësitë kryesore të identifikuara janë si në vijim:

- Zhvillimi i procedurave dhe ligjshmëria e inkasimit të te hyrave; Kalkulim jo i saktë në aplikimin e taksave për shërbimet e kryera nga AUV-i;
- Implementimi i procedurave të prokurimit: Kontratat nuk përmbajnë çmimin për shërbimet përkatëse (AUV), specifikacioni teknik në dosjen e prokurimit përfshinë kërkesa për pajisje jo adekuate për automjetet e Entitetit;
- Menaxhimi i shpenzimeve të karburanteve dhe formave të raportimit për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare; dhe
- Menaxhimi i subvencioneve, përkatësisht plotësimit të planit dinamik në përfundimin e projekteve, të cilat janë mbështetur nga ZKM përmes subvencioneve.

Një numër të dobësive të përmendura me lartë, të cilave ju kemi referuar në kuadër të këtij raporti në lidhje me kualitetin e informatave, realizimin e buxhetit, sistemit për kontroll të brendshëm dhe aplikimin e taksave në kryerjen e shërbimeve nga AUV-i, na ka shtyrë deri te një konkluzion i përgjithshëm që:

- Nevojiten përpjekje të mëtutjeshme në përmirësimin e gjendjes së menaxhimit të te hyrave;
- Sistemi i kontrollit të brendshëm duhet të jetë më funksional ,marrë parasysh menaxhimin e vjeljes së të hyrave, shpenzimeve dhe pasurisë; dhe
- Procedurat e prokurimit duhet të implementohen më mirë dhe menaxhimi i kontrollit të tyre të forcohet.

Në këtë kuptim ne rekomandojmë Sekretarin e Përhershëm që të rishikoj praktikat, sistemet dhe proceset ekzistuese si dhe të analizoj situatën brenda atyre fushave me mangësi të theksuara,

duke ndërmarr veprime të mëtutjeshme përmirësuese që do të përkrahin arritjen e objektivave të përgjithshme të ZKM-së.

Menaxhmentit të ZKM-së i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Më pas një numër i vogël ndryshimesh është bërë në këtë raport.

Çështjet e pa përfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe entiteti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, mund ti gjeni në Shtojcën 2.

Menaxhmenti është zotuar që do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar rekomandimet e dhëna.

## **II. Hyrje**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm sipas ligjit është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë së Institucioneve Publike të Kosovës.

Është përgjegjësi e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës (ZKM) të përgatitë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" në përputhje me Udhëzimin Administrativ 20/2009, dhe ato t'i prezantojë me kohë.

## **III. Objektivi dhe Fushëveprimi i Auditimit**

Ky auditim ka të bëjë me Pasqyrat Financiare të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009.

Auditimi i rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e deklaratave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

## IV. Qasja e auditimit

Qasja jonë e auditimit është zhvilluar gjatë këtij viti. Kemi adoptuar manualin e ri për auditimin tonë të rregullsisë që është më konform standardeve të auditimit të njohura ndërkombëtarisht. Ne kemi fokusuar qasjen tonë të auditimit në katër fushat kryesore, si vijon:

- Të kuptuarit e Entitetit – të kuptojmë plotësisht entitetin, përfshirë këtu edhe kornizën e autoriteteve dhe të sistemeve kyçe, në mënyrë që të kuptojmë çështjet kyçe të cilat mund të kenë ndikim në pasqyrat financiare;
- Identifikimi i Rrezikut: duke kuptuar Entitetin dhe nga rezultatet e mëhershme të auditimit, ne identifikojmë rreziqet të cilat mund të shpijnë në keq deklarim material në pasqyra financiare ose mospërputhshmëri me ligjin;
- Kontrollat e Brendshme të Menaxhimit: aty ku identifikohen rreziqet, ne kërkojmë të identifikojmë menaxhimin dhe kontrollat monitoruese të cilat mund të zvogëlojnë ato rreziqe; dhe
- Përdorimi i Procedurave Substanciale dhe Analitike – për të ofruar një siguri të auditimit me vëmendje të veçantë tek fushat ku dobësitë në kontrole janë identifikuar.

Ne duhet kuptuar kontrollat e brendshme mjaftueshëm për të vlerësuar rrezikun e keq deklarimit material. Në përputhje me këtë kërkesë dhe punën tonë sipas kontroleve të brendshme të menaxhimit të theksuara më lart, ne dokumentojmë kontrollat e menaxhimit dhe ato monitoruese që të na ndihmojnë në informimin e gjykitimit tonë për rreziqet e keq deklarimit material.

Ne planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të qenë në gjendje të ofrojmë siguri të arsyeshme. Ne aplikojmë materialitetin për të na ndihmuar në planifikimin e auditimit tonë dhe vlerësimin e të gjeturave tona të auditimit. Në terme të përgjithshme, ( siç specifikohet në standardet e auditimit) ne konsiderojmë që një çështje është materiale nëse mos shpalosja, keq deklarimi, përfshirja ose lënie jashtë e saj, me gjasë do të mund të ndërronte pikëpamjen e përgjithshme të dhënë nga pasqyrat financiare tek shfrytëzuesit.

Sipas qasjes sonë të rishikuar të auditimit, ne ndërmorëm një auditim të parakohshëm përgjatë këtij viti. Auditimi i parakohshëm duhet të kuptohet si një auditim që fillon nga viti fiskal që është nën auditim me qëllim të dhënies së rekomandimeve mbi atë se si:

- Mund të trajtohen rekomandimet e mëparshme;
- Të adresohen Pasqyrat Vjetore Financiare; dhe
- Të adresohen çështjet e menaxhimit financiar gjatë vitit aktual.

Këtë vit ne kemi raportuar konkluzionet dhe rekomandimet tona nga auditimet e parakohshme në Memorandumet e Auditimit, në Janar të vitit 2010.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë tona për auditimin e ZKM -së, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar pasqyrat financiare të ZKM-së në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2009;

- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të ZKM -së janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të te hyrave, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në ZKM.

Në këtë raport në përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2009.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të ZKM-së, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet. Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 1.

## **V. Opinioni i auditimit**

Për mendimin tonë pasqyrat financiare *paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë* në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009 në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (SNKSP) “raportimi financiar, në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”. (SNISA 400 *Opinion i Pakualifikuar*).

## **VI. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara**

Raporti ynë i auditimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2008 kishte dhënë 9 rekomandime për ZKM-në dhe Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës (AUV) kishte katër. Nga këto rekomandime, nëntë prej tyre janë implementuar plotësisht, ndërsa katër të tjera janë në proces të implementimit.

Rekomandimet ende të pa adresuara plotësisht janë:

- Të planifikohen dhe regjistrohen në mënyrë të plotë të hyrat, përkatësisht të mblidhen sipas faturimeve të bëra;
- Të vendosën kontrole adekuate për të siguruar se të gjitha aktivitetet e prokurimit janë në pajtueshmëri të plotë me Ligjin e prokurimit publik;
- Të sigurohet bazë e qartë ligjore për inkasimin e taksave në kufi për importe të caktuara apo në të kundërtën të ndërpres aplikimin e këtyre taksave ndaj qytetarëve apo bizneseve; dhe
- Të sigurohet menaxhim më i mirë i kontrollit të brendshëm, në zbatimin e procedurave të kontrollit.

## VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

### VII.1 Rezultati Financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1: Përshkrimi i të hyrave të buxhetuara dhe shpenzimeve aktuale.

	<b>Buxheti Fillestar</b>	<b>Buxheti Rishikuar</b>	<b>Buxheti Final</b>	<b>2009 Realizimi</b>	<b>2008 Realizimi</b>	<b>2007 Realizimi</b>
Grandi i Qeverisë – Buxheti	4,903,469	8,322,630	8,465,132	7,438,592	4,073,073	3,279,476
Te hyrat			324,944	89,391	-	-
Donacionet e brendshme			685,998	490,215	13,460	-
Donacionet e jashtme			506,851	189,376	16,605	155,172
<b>Totali i të hyrave të buxhetuara,</b>	<b>4,903,469</b>	<b>8,322,630</b>	<b>9,982,924</b>	<b>8,207,574</b>	<b>4,103,138</b>	<b>3,434,648</b>
Rrogat dhe pagat	1,166,687	1,593,681	1,742,324	1,559,825	929,052	796,197
Mallra dhe shërbime	2,221,992	2,765,006	3,214,436	2,438,221	2,771,237	1,974,407
Shpenzimet komunale	124,700	165,408	166,923	88,747	116,422	70,992
Subvencionet dhe transferet	1,390,090	1,498,381	2,042,879	1,634,897	253,278	391,056
Investimet Kapitale	0	2,300,154	2,816,363	2,485,885	33,150	201,996
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>4,903,469</b>	<b>8,322,630</b>	<b>9,982,924</b>	<b>8,207,574</b>	<b>4,103,138</b>	<b>3,434,648</b>

Buxheti fillestar respektivisht buxheti i rishikuar (kolona 1 dhe 2 e tabelës) paraqet limitin e shpenzimeve të ZKM-së të vendosur nga Kuvendi.

Ky buxhet në fillim ishte 4,903,469€. Ndërsa me rishikimin e buxhetit në mes vitit , buxheti i ZKM-së ishte rritur në 8,322,630€. Rritja është bërë në gjitha kategoritë ekonomike, kjo ka ndodhur për shkak të kalimit të Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinës (AUV) nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), në kuadër të ZKM-së.

Sipas memorandumit mes AUV-it dhe ZKM-së, raportimi i të hyrave vetanake të AUV-it në ZKM, ishte bërë prej 1 shtatorit 2009, ndërsa ai i shpenzimeve prej fillimit të Qershorit të vitit të njëjtë.

Me rastin e buxhetimit dhe rishikimit të tij, të hyrat vetanake dhe donacionet nuk ishin përfshirë. Kjo kishte ndikuar që buxheti final të rritej në raport nga ai i rishikuari. Përveç tjerash, me vendimet e caktuara të Zyrës së Kryeministrit, kishte ndodhur një rritje e buxhetit në kategorinë ekonomike të subvencioneve dhe investimeve kapitale. Kjo rritje mund të shihet në tabelën nr.1.

Sipas memorandumit të lartë përmendur, nga totali i të hyrave vetanake të mbledhura, AUV-së mund t'i alokohen për shfrytëzim vetëm 9.7 % prej tyre ndërsa pjesa tjetër mbetet brenda BKK-së.



## VII.2 Pasqyrat Financiare

### VII.2.1 Cilësia e informatave

Pasqyrat Financiare të sektorit publik duhet të japin informata për të ndihmuar vendimmarrjen dhe të ofrojnë dëshmi për përgjegjësinë e organizatës për burimet e saja dhe transparencën gjatë shpenzimit të parasë shtetërore ( SNKSP 1).

ZKM, gjatë vitit fiskal ka zhvilluar forma të raportimit financiar në baza mujore, po ashtu edhe vjetore, në përputhje me kërkesat rregullative të LMFPP-së dhe rregullave të tjera financiare (Thesarit).

Informatat e prezantuara në PF në të gjitha aspektet janë në përputhje me kontabilitetin e Thesarit (Free Balance), dhe dokumentet burimore të mbajtura brenda ZKM-së.

### VII.2.2 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Kemi vërejtur se Pasqyrat Financiare të ZKM-së janë:

- Përgatitur sipas UA 20/2009 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore, në gjuhën shqipe;
- Nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar i entitetit;
- Përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” ;dhe
- Dorëzuar në MEF (Drejtorit të Thesarit) me datë 29 Janar 2010.

## VII.3 Realizimi i Buxhetit

### VII.3.1 Menaxhimi i të hyrave

Të hyrat vetanake të ZKM-së për vitin 2009 ishin 1,993,801€. Ndërsa të hyra nga donacionet ishin në vlerë prej; 1,192,488€, (Shih tabelën 2).

Tabela 2. Përshkrimi i të hyrave vetanake sipas programeve.

Programi	Të hyrat vetanake 2009	Të hyrat nga donacionet
Të hyrat nga administrata	788,832	755,563
Të hyrat nga AUV	1,204,969	436,925
<b>Të hyrat vetanake ZKM</b>	<b>1,993,801</b>	<b>1,192,488</b>

Shënim: Të hyrat e prezantuara në tabelë janë të realizuara vetëm gjatë periudhës sa AUV është transferuar nga MBPZHR në kuadër të ZKM-së. Ndërsa vlera totale e të hyrave të AUV-së, që përfshinë edhe donacionet është 3,972,751€.

Të hyrat vetanake në ZKM, janë realizuar nga: koncesionet(qiraja), gazeta zyrtare, dhe taksat tjera administrative. Ndërsa të hyrat vetanake nga AUV janë inkasuar përmes: Shërbimeve të dezinfektimit, Inspektimit fitosanitar dhe pranimeve tjera.

## **Të gjeturat**

Të hyrat nga qiraja, realizohen bazuar në marrëveshjen në mes të UNMIK-ut dhe INA-Zagrebit (Industria e naftës). Sipas kësaj marrëveshje, kjo e dyta shfrytëzon pasurinë dhe objektet publike të trashëguara nga ish sistemi shtetëror i mëhershëm.

Ndonëse ZKM bën faturimin për çdo muaj, kemi vërejtur se nuk janë inkasuar të gjitha mjetet sipas faturimit.

Gjendja e tillë e krijuar është si pasojë e papërgjegjësisë së qiramarrësit në kryerjen e obligimeve me kohë, por edhe për shkak të mos ndërmarrjes së masave adekuate të menaxhmentit ndaj qiramarrësit, për kryerjen e obligimeve të tilla.

Kjo ka rezultuar me një saldo prej 220,051€ të mjeteve të pa mbledhura në fund të vitit.

## **Të Hyrat nga Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës (AUV)**

AUV realizon të hyra duke u mbështetur në Ligjin Nr.03/L – 016 për ushqimin si dhe Udhëzimet e tjera administrative përcjellëse. Të hyrat e mbledhura rrjedhin nga shërbimet e dezinfektimit, inspektimit fitosanitar dhe nga inspektimet tjera veterinare.

### Të Hyrat nga Dezinfektimi

Bazuar në Udhëzimin e brendshëm Administrativ Nr.08/2005, AUV është i obliguar që të përcjellë pikat kufitare në vend, dhe përmes aktiviteteve të saj të realizoj të hyra në bazë të tarifave të përcaktuara.

Megjithëkëtë AUV nuk ka arritur që të ushtroj aktivitetin e saj në pikat kufitare të emëruara si G1 dhe G31, në pjesën veriore të Kosovës. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos funksionimit të këtyre pikave për shkak të problemeve politike apo edhe të mos aktiviteteve të mjaftueshme të zhvilluara nga stafi i AUV-it në këto pika.

Kjo situatë ka pasur për efekt mbledhjen e ulët të mjeteve, si dhe ka rrezikuar bartjen e ndonjë sëmundje eventuale për shkak të mos dezinfektimit të nevojshëm.

Të hyrat e mbledhura të ZKM-së nga ky aktivitet kanë qenë në vlerë prej 206,565€

### Të hyrat nga Inspektimi Fitosanitar në kufi

Inkasimi i të hyrave nga shërbimet e Fitosanitarisë kryhen bazuar në Udhëzimin Administrativ MA- Nr. 16/2006, sipas të cilit janë përcaktuar taksat për leje importi dhe taksat për shërbime të kontrollit fitosanitar.

Inspektimi i kontrollit fitosanitar në pikat kufitare është përgjegjës për aplikimin e tarifave përkatëse për shërbimet e kryera.

Në dosjet e testuara kemi identifikuar gabime në kalkulimin e lartësisë së taksave për produkte të importuara. Për më tepër kishte llogaritje të taksave edhe për produktet të cilat nuk janë të parapara sipas udhëzimeve në fuqi.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së legjislacionit të plotë për përcaktimin e taksave mbi importin e disa produkteve të rëndësishme, si dhe kalkulimeve duke u bazuar në gjykimet individuale të inspektorëve të AUV-it. Gjendja e tillë i paraprinë një sigurie jo të plotë të inkasimit të të hyrave, apo mbingarkesa e importuesve me taksa jo ligjore.

## Konkluzioni

Të hyrat nga qiraja, nuk janë mbledhur në nivelin e pritur, dhe gjendja e saldosh në fund të vitit tregon mbledhjen e pa mjaftueshme të të hyrave nga ky shërbim. Qiraja e mbledhur nuk regjistrohet direkt në kodin e ZKM-së, por në kodin e përgjithshëm të buxhetit të konsoliduar.

Aplikimi i taksave jo adekuate, kalkulimi jo i saktë i tyre nga inspektorët e AUV-së dhe baza ligjore jo e kompletuar ka rezultuar me nivel jo të kënaqshëm të mbledhjes së të hyrave. Për më tepër mos mbulimi i të gjitha pikave kufitare në kryerjen e shërbimeve të dezinfektimit dhe shërbimeve tjera, përveç efektit të rrezikut për mbledhje të ulët të të hyrave rrezikon edhe mundësinë e bartjes së ndonjë sëmundje eventuale për shkak të mos dezinfektimit të nevojshëm.

### Rekomandimi 1

Rekomandohet Sekretari i përhershëm i ZKM-së që të siguroj:

- Shtimin e aktiviteteve për menaxhimin dhe mbledhjen e të hyrave nga qiraja;
- Përmirësimin e bazës ligjore, dhe marrjen e masave adekuate në kalkulimin e saktë të taksave të aplikuara në kryerjen e shërbimeve nga AUV-i; dhe
- Ushtrimin e fushëveprimit të AUV-së në të gjithat pikat kufitare, me qëllim të rritjes së nivelit të sigurisë së shëndetit publik dhe rritjes së nivelit të mbledhjes së të hyrave.

## VII.3.2 Menaxhimi i Shpenzimeve

### VII.3.2.1 Pagat dhe Mëditjet

Lista e pagave të ZKM-së menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (“MAP”).

Sipas buxhetit të rishikuar, ZKM, ka të punësuar 481 punëtor, prej të cilëve 154 janë punëtor të AUV-së. Shpenzimet për paga dhe mëditje për vitin 2009 ishin në vlerë prej 1,559,825 €.

### Të gjeturat

Rregullorja nr. 2001/36 mbi shërbimin civil përcakton se menaxhimi i dosjeve të personelit kërkon azhurnimin e tyre me kohë, duke bërë plotësimin e dokumenteve të nevojshme. Ne kemi vërejtur se dosjet e personelit në disa raste nuk janë azhurnuar në përputhje me ndryshimet periodike që ndodhin.

### Konkluzioni

Me përjashtim të rasteve individuale të përmendura më sipër të mos azhurnimit të dosjeve, ne nuk kemi gjetur mangësi materiale, të cilat do të mund të rezultojnë me ndonjë rekomandim nga ana jonë që do të duhej të adresohet në të ardhmen.

### VII.3.2.2 Mallrat dhe Shërbimet

#### Shpenzimet e telefonave

Udhëzimi Administrativ Nr.04/2008 për përdorimin e telefonave (fiks dhe mobil) në Qeverinë e Kosovës ka për qëllim përcaktimin e procedurave për përdorimin e rregullt dhe efikas të telefonave në tërë Qeverinë. Kjo është bërë përmes rregullimit normativ të shumës së shpenzimeve të telefonave me qëllim të kryerjes së punëve dhe detyrave në kuadër të përgjegjësive të zyrtarëve të përcaktuar në këtë udhëzim.

Kemi vërejtur se shpenzimet për telefoni fikse dhe roaming për vitin 2009, përkundër hapave të ndërmarrë nga menaxhmenti, kishin tejkaluar kufijtë e përcaktuar për shfrytëzimin e tyre.

#### Shpenzimet e automjeteve

Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2008 për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës, çdo drejtues i automjeteve është i obliguar që të plotësoj formularin për fletëudhëtim, numrin e kilometrave të realizuar, destinimin e udhëtimit si dhe nënshkrimin e përdoruesve.

Gjatë auditimit kemi vërejtur se për 23 automjete nga 54 në listën e nuk i ishin përmbajtur kushteve të këtij udhëzimi.

Një vendim i nxjerrë në vitin 2006 nga Kryeministri i Kosovës kishte përcaktuar limite mujore të shpenzimeve të karburanteve.

Kemi vërejtur tejkalim të limiteve në shfrytëzimin e karburanteve të kalkuluar për vite.

Në tabelën në vijim janë paraqitur disa nga këto tejkalime:

Automjeti	Shpenzimet e lejuara	Shpenzimet e bëra	Shpenzimet e tejkaluara
514 – KS - 854	2400 litra	2732 litra	332 litra
514 – KS - 855	2400 litra	4637 litra	2237 litra
514 – KS - 856	2400 litra	3907 litra	1507 litra

Një kontroll i brendshëm jo adekuat ka lejuar që shpenzimet dhe përdorimi i automjeteve kishte qenë në nivel me të lartë se limitet e përcaktuara, gjë që kjo kishte rezultuar në rritjen e shpenzimeve publike.

#### Shpenzimet tjera kontraktuese

Shpenzimet e ndodhura me rastin e trajnimeve të stafit të AUV-së ishin krijuar duke mos përdorur procedurat e përzgjedhjes së ofertuesve më të lirë për lokacionin e mbajtjes së seminarit.

Ndonëse ekzistonte kontrata, ajo nuk përmbante çmimin e një shërbimi të tillë. Gjithashtu është vërejtur mungesë e dëshmive në detaje të përmbajtjes së seminarit dhe pjesëmarrësve në të.

Si pasojë e mospërfilljes së procedurave të prokurimit, shpenzimet e krijuara në këto raste mund të mos jenë nën kontrollin e duhur dhe procedurat e tilla ndikojnë në mos parandalimin e veprimeve të tilla.

### Shërbimet e servisimit

Procedura e prokurimit për përzgjedhjen e kontraktuesit të ri për shërbime të servisimit ishte bërë me vonesë. Kontrata paraprake për shërbime të servisimit të një kategorie të automjeteve kishte skaduar afërsisht dy muaj më herët.

Specifikacioni teknik për servisim të automjeteve ishte përgatitur në mënyrë jo korrekte, në kuptimin se ishin kërkuar disa pjesë të automjeteve të pa nevojshme për entitetin.

Shqyrtimi i ofertave të OE, marrë për bazë gjendjen e tillë kishte rezultuar me një vlerësim jo adekuat, duke ju shmangur procedurave përkatëse të prokurimit.

### **Konkluzioni**

Kontrolli i brendshëm i tanishëm në kuadër të logjistikës nuk përkonë me kërkesat e praktikave më të mira dhe nuk siguron që organizata ka realizu objektivat e saj përbrenda kësaj kategorie ekonomike.

Njësia shpenzuese përkatësisht njësia e transportit, nuk ka bërë kërkesën me kohë dhe me specifikacion të qartë teknik për pjesët që nevojiten për servisim. Si pasojë zyra e prokurimit ka filluar vetë procedurat e prokurimit, ku njëkohësisht kishte vendosur pozicionet e pjesëve të automjeteve në mungesë të kompetencës profesionale.

Specifikacioni me dobësi të tilla, në pa mundësi për tu plotësuar në të gjitha pozicionet nga OE, ka krijuar mundësinë që dosjet e tenderit (ofertat) të jenë të pa përgjegjshme.

#### **Rekomandimi 2**

Rekomandohet Sekretari i përhershëm i ZKM-së që të siguroj:

- Menaxhim më të mirë të shpenzimeve të telefonit në përputhje me kufijtë e përcaktuar nga ana e Qeverisë së Kosovës;
- Shërbimet tjera kontraktuese të ndodhin duke aplikuar rregullat e përzgjedhjes së ofertave më të lira dhe kontratat të përmbajnë çmimin për shërbimin që do të ndodhë (AUV);
- Shtimin e masave të kontrollit në menaxhimin e shpenzimeve për servisim e mirëmbajtje të automjeteve dhe në krijimin e evidencave të sakta të shpenzimeve tjera;
- Procedura e prokurimit të fillojë para skadimit të kontratës paraprake, si dhe kjo të bëhet me specifikacionet e nevojshme teknike nga njësia shpenzuese përkatëse; dhe
- Vlerësimi i ofertave dhe shpërblyesi i kontratës (si në rastin e prokurimit për servisim) të kenë dosjen e tenderit të përgjegjshme me të gjitha kërkesat e parapara në dosjen e tenderit.

### VII.3.2.3 Subvencionet

Shpenzimet nga subvencionet dhe transferet në ZKM kanë qenë në vlerë prej 1,634,897€. Kryesisht këto shpenzime kishin ndodhur për ndërtimin e shtëpive të personave me nevoja urgjente.

Për realizimin e këtyre aktiviteteve ZKM kishte lidhur memorandum me një organizatë jo qeveritare, e cila kishte marrë për obligim menaxhimin e mjeteve.

Përzgjedhja e operatorit ekonomik ishte udhëhequr nga kjo organizatë jo qeveritare, edhe pse nuk është e cekur në memorandum.

Kjo mënyrë e përzgjedhjes së OE do të mund të krijonte shpenzime jo të kontrolluara dhe menaxhim jo të duhur të mjeteve.

Për më tepër ne kemi vërejtur se edhe pas këtyre shpenzimeve ende nuk ka ndodhur përfundimi i punëve sipas planit dinamik të paraparë.

Dështimi në kryerjen me kohë të punimeve ka ndodhur si pasoj e kushteve natyrore, por edhe të një monitorimi jo adekuat të punëve në teren, dhe mungesa e kontrollit nga ana e ZKM-së.

#### Konkluzioni

Organizata jo qeveritare nuk kishte arritur të përfundoj punët sipas planit dinamik. Dështimi në realizimin e projektit në përputhje me planin ishte pasojë e menaxhimit jo të mirë në mbikëqyrjen e ekzekutimit të punimeve nga ana e ZKM-së.

#### Rekomandimi 3

Rekomandohet Sekretari i përhershëm i ZKM-së që të siguroj:

- Shtimin e masave të kontrollit në monitorimin e punëve në zbatimin e planit dinamik dhe përcjellja e implementimit të memorandumit.

### VII.3.3 Menaxhimi i Prokurimit

Procesi i prokurimit zhvillohet për të parandaluar shpenzimet publike jo efikase, për të ngritur kualitetin e shërbimeve publike, të ndihmoj në zvogëlimin e kostos, në rritje të zhvillimit ekonomik dhe në zgjerim të konkurrencës.

#### Të gjeturat

Të gjeturat e raportuara në nën-kapitujt e mësipërm tregojnë se ZKM, jo gjithëherë ka ndërmarrë procedurat e prokurimit në pajtim me kornizën ligjore.

#### Konkluzioni

Rregullat e prokurimit duhet të mundësojnë trajtim të barabartë, ligjshmëri, korrektësi, ruajtje (kursim) të parasë së tatimpaguesve, për të parandaluar shpenzimet publike jo efikase, për të ngritur kualitetin e shërbimeve publike, të ndihmoj në zvogëlimin e kostos.

Prandaj moszbatimi i rregullave të prokurimit për raste e cekura më lartë do të vijë në dyshim transparencën e shpenzimit të parasë publike dhe kryerjen e shërbimeve kualitative.

#### **Rekomandimi 4**

Rekomandohet Sekretarit Permanent, që të sigurojë se:

- Ekzistojnë kontrole më adekuate për t'u siguruar që procedurat përkatëse të prokurimit (kontraktimit) dhe realizimit janë zbatuar;
- Kontratat e nënshkuara me operatorin ekonomik përmbajnë çmimin e duhur; dhe
- Dosja e tenderit gjegjësisht specifikacioni teknik të përmbajë specifikat e sakta.

### **VII.3.4 Menaxhimi i pasurive**

#### **Të gjeturat**

ZKM kishte ndërmarrë hapa pozitiv në drejtim të pajtueshmërisë me kërkesat e UA 2005/11. Komisionet për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurisë në ZKM dhe agjencionet përkatëse kishin kryer regjistrimin në fund të vitit.

Ndonëse është bërë regjistrimi, një njësi e ZKM-së nuk ka siguruar që lista e pasurisë përmbante të gjitha elementet e duhura si p.sh. mungonte sasia dhe vlera e pasurisë së paraqitur.

Mos paraqitja e sasisë dhe vlerës së pasurisë në listën e regjistrimit, nuk jep rezultate të plota të gjendjes së pasurisë.

#### **Konkluzioni**

Komisioni i regjistrimit dhe vlerësimit të pasurisë i Arkivit të Kosovës, nuk kishte arritur që t'u përmbahet kërkesave ligjore dhe t'i plotësoj të gjitha elementet e pajisjeve në formularin përkatës për regjistrim.

#### **Rekomandimi 5**

Rekomandojmë Sekretarin Permanent që të siguroj:

- Menaxhim efikas të pasurisë përkatësisht komisioni i regjistrimit të pasurisë të përfundoj dhe listoj të gjithë pasurinë sipas sasisë, vlerës dhe elementeve tjera të parapara në formularin e regjistrimit të pasurisë.

## VII.4 Sistemi i Kontrollit të Brendshëm

Nga rishikimet tona kemi konkluduar që kontrolli i brendshëm në kuadër të ZKM-së nuk është plotësisht i kënaqshëm.

Një kontroll i brendshëm efektiv mund të kishte siguruar rezultate më të mira operationale, të hyra më të larta dhe shpenzime më të ulëta.

Mangësitë e shprehura në fushën e menaxhimit të hyrave dhe shpenzimeve, kërkojnë vëmendje më të lartë.

Masat e tanishme të kontrollit të brendshëm në kuadër të ZKM-së përkatësisht AUV-së nuk i përmbushin plotësisht nevojat, standardet dhe kërkesat e praktikave më të mira.

### Rekomandimi 6

Rekomandohet Sekretari Permanent të siguroj:

- Që kontrolli i brendshëm të përforcohet dhe fokusohet në fushat me mangësi; dhe
- Që sistemi i kontrollit të brendshëm rishikohet vazhdimisht nga menaxhmenti për të konfirmuar se është duke funksionuar siç kërkohet dhe është korrigjuar sipas nevojës për t'u adoptuar kërkesave të ndryshme.

## VII.5 Auditimi i Brendshëm

Një sistem efikas i kontrollit të brendshëm i ndihmon Menaxhmentit dhe entitetit në arritjen e objektivave të tyre për ofrimin e shërbimeve më të mira dhe përdorimit sa më të mirë të parave publike.

Ai duhet ta ketë për synim përmirësimin e kontroleve për të siguruar raportim të besueshëm financiar, përfitim maksimal, ruajtjen e pasurive dhe respektimin e ligjeve dhe rregulloreve.

Një Auditim i brendshëm funksionues dhe i pavarur duhet të jetë pjesë e sistemit të kontrollit të brendshëm pasi që mund të ofrojë siguri rreth përshtatshmërisë së sistemit dhe të japë rekomandime për përmirësim.

Me rastin e auditimit tonë, ne kemi vërejtur se ZKM ka në funksion Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB). Kjo njësi përbëhet nga një auditor.

NjAB kishte përgatitur planin vjetor të auditimit, përmes se cilit kishte paraparë që të realizohen auditime, në njësi dhe fusha të ndryshme brenda entitetit. Ky kishte bërë katër raporte auditimi që një kishte të bënte për vitin financiar 2008 derisa tre kishin të bënin me vitin 2009.

Auditimet e bëra ishin të një kualiteti të arsyeshëm bazuar në vlersimin e riskut. Këto auditime kanë rezultuar me rekomandime më pas të implementuara nga ZKM-ja.

Sa i përket Komitetit të Auditimit ZKM ka të themeluar atë.



## **VII. 6 Një konkluzion i përgjithshëm mbi Menaxhmentin e ZKM-së**

Menaxhmenti i ZKM-së nuk kishte arritur plotësisht parakushtet e nevojshme për një menaxhim publik financiar të mirë dhe kontrole të brendshme adekuate.

Një numër të dobësive të përmendura me lartë, të cilave ju kemi referuar në kuadër të këtij raporti në lidhje me kualitetin e informatave, realizimin e buxhetit, sistemit për kontroll të brendshëm dhe aplikimin e taksave në kryerjen e shërbimeve nga AUV-i, na ka shtyrë deri te një konkluzion i përgjithshëm që:

- Nevojiten përpjekje të mëtutjeshme në përmirësimin e gjendjes së menaxhimit të te hyrave;
- Sistemi i kontrollit të brendshëm duhet të jetë më funksional ,marrë parasysh menaxhimin e vjeljes së të hyrave, shpenzimeve dhe pasurisë; dhe
- Procedurat e prokurimit duhet të implementohen më mirë dhe menaxhimi i kontrollit të tyre të forcohet.

Në këtë kuptim ne rekomandojmë Sekretari i Përhershëm që të rishikoj praktikat, sistemet dhe proceset ekzistues, si dhe të analizoj situatën brenda atyre fushave me mangësi të theksuara, duke ndërmarr veprime të mëtutjeshme përmirësuese që do të përkrahin arritjen e objektivave të përgjithshme të ZKM-së.

## Shtojca 1

### Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj

qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionin i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtitimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinionin e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

**14. Opinioni i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionin i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

**15. Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinionin që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionin i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë të kundërt e bënë të qartë që një opinionin nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinionin jo i kualifikuar.

## Shtojca 2

### ZYRA E KRYEMINISTRIT TË KOSOVËS

Menaxhmentit të ZKM-së i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Menaxhmenti ka dhënë një numër komentesh të cilat i kanë qartësuar çështjet e ngritura dhe më pas janë bërë disa ndryshime. Çështjet e pa përfunduara për të cilat ne si auditorë dhe entiteti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, janë si më poshtë:

Çështja	Komentet e auditorit	Komentet e AQ	Përgjigjet e Auditorit në komentet e MEF
<b>Rekomandimi 1:</b>	<p>-Shtimin e aktiviteteve për menaxhimin dhe mbledhjen e të hyrave nga Qiraja;</p> <p>- Përmirësimin e bazës ligjore, dhe marrjen e masave adekuate në kalkulimin e sakët të taksave të aplikuara në kryerjen e shërbimeve të AUV-it;</p> <p>- Ushtrimin e fushëveprimit të AUV-it në të gjitha pikat kufitare, me qëllim të sigurisë së shëndetit publik dhe arritjes së inkasimit të mjeteve.</p>	<p>Taksat fitosanitare mblidhen sipas AU MA Nr. 16/2006 dhe ato janë të caktuara në mënyrë gjeneralë e jo veç e veç për çdo artikull. AUV veç është duke e përgatit udhëzimin e ri administrativ për këto taksa dhe jemi të bindur që të njëjtin së shpejti do t'a procedojmë për nënshkrim në ZKM me çka do të rregullohet edhe kjo çështje.</p> <p>Shpresoj se edhe ju jeni të vetëdijshëm për gjendjen aktuale në pikën G 1 dhe G 31 në Veri të Republikës së Kosovës – në të cilat nuk janë në funksion barrierat dezinfektuese. Kjo çështje do të zgjidhet si çështje e përgjithshme për çka AUV është e gatshme të jep kontributin e vet.</p>	<p>Nga komentet e ZKM-së vërejmë se me gjithë arsyetimet e bëra, ne përgjithësi është pajtuar me te gjeturat dhe rekomandimet tona.</p>
<b>Rekomandimi 2:</b>	<p>-Menaxhimi më i mirë të telefonit në përputhje me kufijtë e përcaktuar nga ana e Qeverisë së Kosovës;</p>	<p>E gjetura e auditorit qëndron se në fillim të vitit ka pasur disa tejkalime të vogla të shpenzimeve, mirëpo ato lidhen me përmbushjen e detyrave të punës së zyrtarëve dhe pas muajit mars 2009 e këndej këto shpenzime kanë qenë më të kontrolluara dhe janë zvogëluar dukshëm në krahasim me vitet e mëparshme. Zyrtarët të cilët kanë bërë tejkalime ju është ndaluar qasjes në telefona si masë e parandalimit të tejkalimeve të shumave të caktuara apo limiteve të caktuara me UA nr 04/2008 dhe kjo masë u tregua efektive.</p>	<p>ZKM, sqaron hapat që janë ndërmarrë në këtë proces, menaxhmenti i ZKM-së pajtohet me të gjeturën dhe rekomandimin tonë, dhe çështja mbetet në adresim të mëtejshëm.</p>

	<p>- Shërbimet tjera kontraktuese të ndodhin duke aplikuar rregullat e përzgjedhjes së ofertave më të lira dhe kontratat të përmbajnë çmimin për shërbimin që do të ndodhë (AUV);</p> <p>- Shtimin e masave të kontrollit në menaxhimin e shpenzimeve për servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve dhe në krijimin e evidencave të sakta të shpenzimeve tjera;</p> <p>- Procedurat e prokurimit të fillojnë para skadimit të kontratës paraprake, si dhe kjo të bëhet me specifikacionet e nevojshme teknike nga njësia shpenzuese përkatëse;</p> <p>- Vlerësimi i ofertave dhe shpërblyesi i kontratës të kenë dosjen e tenderit të përgjegjshme me të gjitha kërkesat e parapara në dosjen e tenderit.</p>	<p>Sa i përket procedurave të prokurimit AUV është e përkushtuar që t'i respektojë procedurat ligjore nga kjo fushë.</p> <p>Konkludimet e auditorit mbi shërbimet e sevisimet të automjeteve (xhip Taureg) faqe 10 paragrafi 1. E posaqerisht rekomandimi i fundit në tabel për vlersimin e llotit 3 të tenderit në fjalë nuk qëndrojnë Zyra e prokurimit gjithmonë në bashkëpunim më zyren e transportit, përvojat e mëhershme në specifika teknike pranë ZKM-së, dhe ndonjëherë marrjen e specifikave të mira nga ndonje organizatë tjetër buxhetore të vendit, ka publikuar tenderin në fjalë</p> <p>Që të jemi sa më profesional, dhe të kemi sa më shumë elemente të automjeteve në dosje, me kusht që në të ardhmen ta kemi më të lehtë realizimin e servisimeve, zyra e prokurimit ka fut në dosje 233 elemente të cilat për aq sa ne dinim, kishin mundësi të defektoheshin më shpesh, (shih dosjen e bashkangjitur të llotit 3)</p>	<p>Formulari i tenderit nr. ZK 104-09-122-221, që përmban specifikacionin e pjesëve të automjeteve, në të janë të përfshira edhe pjesë të cilat nuk i përkasin automjetit përkatës për të cilin është publikuar tenderi. Prej të gjitha pozicioneve të paraqitura në specifikacionin e tenderit (239), për 38 pozicione njëri ofertues nuk ka plotësuar formularin, gjersa ofertuesi tjetër në specifikacionin e pjesëve dhe materialit për automjetin, për 33 pozicione nuk ka ofruar ndonjë çmim për njësi. Për më tepër pozicionet e pa plotësuar nga ofertuesit nuk janë të njëjtë. Kjo çështje lenë të kuptohet se formulari i tenderit nuk ka përmbajtur saktë pjesët që i përkasin automjetit përkatës.</p>
<p><b>Rekomandimi 4:</b></p>	<p>- Të ekzistojnë kontrole më adekuate për tu siguruar që procedurat përkatëse të prokurimit ( kontraktimit ) dhe realizimit janë zbatuar;</p> <p>- Kontratat e nënshkruara me operatorin ekonomik përmbajnë</p>	<p>Zyra e Prokurimit gjithmonë në bashkëpunim më Zyrën e Transportit, përvojat e mëhershme në specifika teknike pranë ZKM-së, dhe ndonjëherë marrjen e specifikave të mira nga ndonjë organizatë tjetër buxhetore të vendit, ka publikuar tenderin në fjalë. Që të kemi sa më shumë elemente të automjeteve në dosje, me kusht që në të ardhmen ta kemi më të lehtë realizimin e servisimeve, Zyra</p>	<p>Komenti i menaxhmentit është i njëjtë sikur tek rekomandimi nr.2, atëherë përgjigja ndaj komentit të tillë mbetet e ngjashme.</p> <p>Prandaj të gjeturat dhe rekomandimet tona mbesin për</p>

	<p>çmimin e duhur;</p> <p>- Dosja e tenderit gjegjësisht specifikacioni teknik të përmbajë specifikat e sakta.</p>	<p>e Prokurimit ka futur në dosje 233 elemente të cilat për aq sa ne dinim, që do të defektoheshin më shpesh, (shih pjesën në dosjen e bashkangjitur të llotit 3).</p> <p>Dosja tenderike në fjalë, ka qenë pjesë edhe e kontrollimit të bërë nga APP-ja për shkak të kërkesës së bërë nga ne për revokim të nenit 30A.4, aprovim ky të cilin e kemi marrur me datën 23.10.2009 shih (dokumentin aprovues nga APP).</p> <p>Dosja ka qenë e njëjtë për të gjithë operatorët,(bëni krahasimin e dosjeve).</p> <p>Ofertat financiare të dy operatorëve siç jeni në dijeni janë : Porshe Kosova fituese 49,878.04 dhe oferta Baki automobile 79,694.00 diferenca 29,216.00 (-49.79% ).</p>	<p>tu adresuar nga menaxhmenti i ZKM-së.</p>
<p><b>Rekomandimi 5:</b></p>	<p>- Menaxhim efikas të pasurisë përkatësisht komisioni i regjistrimit të pasurisë të përfundojnë dhe listojnë gjithë pasurinë sipas sasisë, vlerës dhe elementeve tjera të parapara në formularin e regjistrimit të pasurisë.</p>	<p>Pajtohem me vlerën që është cekur e cila mund të mos jetë reale për arsye se disa pajisje-inventar të viteve të më hershme nuk janë gjetur faturat dhe janë vlerësuar nga Komisioni për vlerësim, mirëpo nuk pajtohem me gjendjen fizike e cila ekziston e gjitha si nëpër Agjensione gjithashtu edhe në ZKM.</p> <p>Sasia e gjitha është e regjistruar në programin për mirëmbajtjen e pasurisë.</p> <p>Mundësisht kërkoj të cekem se për cilin Agjencion të ZKM-së është e gjetura.</p>	<p>Në këtë situatë menaxhmenti i ZKM-së, tregon se ka filluar së trajtuar çështjet e ngritura në të gjeturat tona. Komisioni i vlerësimit dhe regjistrimit të pasurisë së Arkivit të Kosovës nuk kishte arritur që të plotësoj formularin e regjistrimit të pasurisë me gjithë karakteristikat e duhura.</p> <p>Prandaj rekomandimet tona mbesin për tu adresuar nga menaxhmenti i ZKM-së.</p>

Më tutje, Menaxhmenti është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.